

VENDIM
Nr. 788, datë 12.12.2022

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 428, DATË 8.7.2021, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR
FINANCIMIN E RIKONSTRUKSIONIT TË OBJEKTEVE ARSIMORE, NË
BASHKINË KURBIN DHE CAKTIMIN E BASHKISË KURBIN SI NJËSI
ZBATUESE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarjet “i”, dhe “iii”, 16 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 2, të vendimit nr. 428, datë 8.7.2021, të Këshillit të Ministrave, shtohet pika 2/1, me këtë përmbajtje:

“2/1. Bashkisë Kurbin, për vitin 2022, i transferohet fondi, në masën 30 580 000 (tridhjetë milionë e pesëqind e tetëdhjetë mijë) lekë pa TVSH, në formën e transfertës së pakushtëzuar, për financimin e rikonstruksionit të objekteve arsimore në Bashkinë Kurbin, i cili përballohet nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2022, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare Milot, Bashkia Kurbin, në masën 9 174 000 (nëntë milionë e njëqind e shtatëdhjetë e katër mijë) lekë pa TVSH;

b) Rikonstruksion i shkollës së mesme “Milot”, Bashkia Kurbin, në masën 21 406 000 (njëzet e një milionë e katërqind e gjashtë mijë) lekë pa TVSH.”.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Kurbin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku